

Vendim nr. 96 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (M) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: MIHAL LOLO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit 00-2023-3223, datë 06.07.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit të ankimeve të veçanta nr. 31133-00796-86-2021, datë 08.03.2021; nr. 31157-00893-86-2021, datë 16.03.2021.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për përsheptimin e gjykimit.

Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për gjykimin e të dyja ankimeve të veçanta brenda 30 ditëve.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i

**ndryshuar (ligji nr. 8577/2000); nenet 399/1e vijues
dhe 471 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Mihal Lolo ka paraqitur padi përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), Drejtoria Vendore Gjirokastrë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të shkresave të Drejtorisë Vendore të *ASHK*-së Gjirokastrë nr.1055 prot., datë 10.04.2019, nr. 283/1 prot., datë 01.08.2019 dhe nr. 3920 prot., datë 06.08.2020, urdhërimin e organit administrativ për korrigjimin e gabimit material në certifikatë, si dhe detyrimin që t'i paguajë paditësit (kërkuesit) shumën 700,000 lekë për dëmin moral të shkaktuar si rezultat i cenimit të gëzimit paqësor të pronës në mënyrë të vazhdueshme.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, në seancën përgatitore të datës 25.01.2021, ka marrë në shqyrtim kërkesën e paditësit (kërkuesit) për përjashtimin e tij nga tarifa gjyqësore dhe me vendim të ndërmjetëm të asaj date ka vendosur rrëzimin e saj. Në vijim ajo ka konstatuar të metat e padisë lidhur pikërisht me pagesën e tarifës gjyqësore, për rrjedhojë paditësit i është dërguar njoftim për plotësimin e të metave përpara seancës së ardhshme. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin e datës 08.02.2021 ka vendosur mospranimin e tij, bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr.49/2012*). Kundër këtij vendimi, në datën 18.02.2021, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

3. Për sa i përket procesit të shqyrtimit të kërkesëpadisë, në seancën përgatitore të radhës, të datës 09.02.2021, gjykata ka konstatuar mungesën e paditësit (kërkuesit) ashtu edhe mungesën e pagesës së tarifës gjyqësore, për rrjedhojë ka vlerësuar se padia dhe aktet e saj duhet t'i kthehen paditësit (kërkuesit) si një padi me të meta të paplotësuar, bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenet 154, 154/a dhe 158/a të KPC-së. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit, duke pretenduar se ai është marrë në shkelje të rënda procedurale.

4. Në Gjykatën Administrative të Apelit, mbi bazën e këtyre ankimeve të veçanta të kërkuarit, janë regjistruar dy çështje të ndryshme. Duke pretenduar se ato nuk janë marrë në shqyrtim në përputhje me afatin 30-ditor, të parashikuar nga nenet 470 dhe 471/a të KPC-së, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 10.05.2023, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në çështjet administrative nr. 31133-00796-86-2021, datë regjistrimi 08.03.2021 dhe nr. 31157-00893-86-2021, datë regjistrimi 16.03.2021, si dhe urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e gjykimit. Sipas kërkuarit, të dyja ankimet e veçanta të paraqitura prej tij përbëjnë çështje me natyrë dhe kategori specifike, për të cilat parashikohet përshpejtimi i gjykimit, pasi ai është i moshës 76 vjeç; mosmarrëveshja lidhet me cenimin e tagrit të disponimit të pronës dhe parimit të gjësë së gjykuar; kërkuari ka shteruar ankimin administrativ përmes të cilit i është dhënë e drejtë nga drejtori i ASHK-së; ai ka depozituar certifikatën origjinale të pronësisë, por nuk e pajisin me certifikatë të re pa nxjerrë urdhërkufizimin.

5. Me vendimin nr. 00-2023-3223, datë 06.07.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pasi ka marrë edhe mendimin e gjyqtarës relatores në Gjykatën Administrative të Apelit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas atij Kolegji, mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarës, e cila ka realizuar edhe një praktikë për marrjen në shqyrtim të çështjeve ku është caktuar në cilësinë e relatores, duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Po sipas Kolegjit Administrativ, është e pakuptimtë që të konstatohet shkelja e afatit të arsyeshëm të gjykimit pa urdhëruar njëkohësisht edhe masën efektive që do të shërojë shkeljen e konstatuar, që, në rastin konkret, do të ishte urdhërimi i gjykatës më të ulët për gjykimin e çështjes brenda një afati të caktuar. Në mungesë të veprimeve nga ana e gjykatës, që përbëjnë administrim të parregullt gjyqësor të çështjes dhe që lidhen me aspekte subjektive të gjyqtarës relatores, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nuk mund të konstatohet shkelja e afatit të arsyeshëm dhe të urdhërohet gjykimi i çështjes, pasi çështja nuk po gjykohet për shkak të pamundësisë objektive dhe jo për shkak të neglizhencës gjyqësore, për sa kohë nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme nga gjyqtari relator (*shih paragrafët 19 dhe 20 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

6. Në datën 07.02.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.03.2024.

II

Pretendimet e kërkuessit

7. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

7.1. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi konkluzioni i Gjykatës së Lartë se mosveprimi i gjykatës ka ndodhur për shkaqe subjektive dhe se shqyrtimi bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar, bazohet në konsiderata të paarsyetuara, pasi kjo radhë ndiqet për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve përfundimtare, jo për ankimet e veçanta. Edhe qëllimi i ligjvënësit në miratimin e ndryshimeve të vitit 2017 ka qenë që ritmi i ankimeve të veçanta nuk mund të jetë i njëjtë me atë të gjykimit të ankimeve të zakonshme. Në nenin 471/a të KPC-së është parashikuar afati 30-ditor i shqyrtimit të ankimit të veçantë nga momenti i regjistrimit të çështjes, çka do të thotë se ligjvënësi e ka konsideruar atë si afat të arsyeshem. Në vendimin e kundërshtuar nuk ka asnjë referim dhe qëndrim bazuar në këtë dispozitë dhe mungesa e arsytimit në këtë drejtim e bën të paarsyetuar. Në vendim nuk ka ndonjë referencë dhe arsytim as në lidhje me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, për sa u përket kritereve që duhen marrë në shqyrtim në këtë drejtim.

7.2. Me rrëzimin e kërkesës nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mjeti juridik në dispozicion të kërkuessit, sipas nenit 399/6 të KPC-së, nuk i ka shërbyer qëllimit të tij, përshpejtimin të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të dy ankimeve të veçanta të paraqitura nga ai në gjykatën e apelit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuessit*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në

mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji konstaton se e drejta kushtetuese për proces të rregullt, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, ka si element të saj edhe të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm gjatë procesit gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të individit ose në rastin e akuzave penale kundër tij. Për rrjedhojë, kjo e drejtë, me karakter procedural, synon të mbrojë individin gjatë procesit gjyqësor në të cilin vihen në diskutim të drejtat substanciale të tij. Për këtë qëllim, ligji procedural ka parashikuar mjete juridike me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Më konkretisht, dispozitat e KPC-së (nenet 399/1 e vijues të tij) kanë parashikuar mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme të procesit, duke përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme, mjetet e mbrojtjes nga cenimi (kërkesa për përshpejtim dhe kërkesa për dëmshpërblim), gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës, rregullat për gjykimin etj.

11. Kolegji vëren se, në rastin konkret, kërkuesi ka ngritur pretendime për kohëzgjatjen e paarsyeshme, nga Gjykata Administrative e Apelit, të shqyrtimit të dy ankimeve të veçanta të paraqitura prej tij kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, konkretisht atij për mospranimin e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm që ka vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuetit për përjashtimin nga tarifa gjyqësore dhe atij për kthimin e kërkesëpadisë bashkë me aktet. Sipas kërkuetit, për ankimet e veçanta është i zbatueshëm afati 30-ditor i shqyrtimit dhe nuk gjejnë zbatim afatet e zbatueshme për gjykimet e zakonshme.

12. Kolegji vëren se proceset gjyqësore për të cilat kërkuesi ka ngritur pretendime në Gjykatë në drejtim të cenimit të së drejtës për proces të rregullt në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit kanë të bëjnë me shqyrtimin e dy vendimeve të ndërmjetme të dhëna ndaj tij dhe jo me procesin e themelit të mosmarrëveshjes, për të cilën ai ka vënë në lëvizje gjykatën. Kolegji vëren se edhe pse vendimet e kundërshtuara nga kërkuesi janë dhënë gjatë procesit gjyqësor të vënë në lëvizje prej tij, ato kanë të bëjnë me procedura që, pavarësisht se zhvillohen nga gjykata në kuadër të atij procesi, nuk janë përcaktuese të atyre të drejtave substanciale të kërkuetit që ai ka synuar të mbrojë përmes atij gjykimi. Kërkuesi nuk ka

parashtruar përpara Gjykatës dhe nuk ka argumentuar në lidhje me fazën në të cilën ndodhet procesi gjyqësor i themelit të çështjes, përmes të cilit ai ka të gjitha drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe mbrojtjen kushtetuese pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike që ofron sistemi gjyqësor i zakonshëm. Po kështu, përmes shterimit të këtyre mjeteve të ankimit kërkuesi ka mundësinë që në procesin e themelit të rivendosë edhe ato të drejta të pretenduara të cenuara nga gjykata me vendimet e ndërmjetme të dhëna prej saj.

13. Në kontekst të sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës sipas objektit të ankimit kushtetues individual.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.